



161/11
18 8 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 9078/ prot.
2

Data: 11 . 8 . 2025

VENDIM

Nr. 79 , Datë 11 , 8 , 2025

PËR
VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN E MESME INDUSTRIALE
“PETRO SOTA”, FIER

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, “Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”, si dhe raportit të monitorimit të posaçëm për Skollën e Mesme Industriale “Petro Sota” Fier, dërguar nga AKAFPK me shkresën nr. 161/10prot.. datë 08.07.2025.

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së , Shkolla e Mesme Industriale “Petro Sota” Fier, ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr.78 datë 13.11.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “**Akreditim me kusht**” me afat vlefshmërie deri më 12.05.2025.

2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin nr. 30 datë 08.07.2025, të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv “**Akreditim i plotë**” dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas Vendimin nr. 78 datë 13.11.2024, të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për kualifikimet profesionale si më poshtë vijon:

- “Elektroteknikë” Niveli II i KSHK-së, E-II-21
- “Instalime elektrike, civile dhe industriale” Niveli III i KSHK-së, E1-III-21
- “Elektroteknikë” Niveli IV i KSHK-së, E-IV-21;
- “Mekanikë” Niveli II i KSHK-së, F-II-22;
- “Mirëmbajtje dhe riparime mekanike”, Niveli III i KSHK-së, F3-III-18;

- dh) "Mekanikë" Niveli IV i KSHK-së, F-IV-19;
- e) "Shërbime mjetes transporti" Niveli II i KSHK-së, M-II-21;
- ë) "Shërbime elektro-auto" Niveli III i KSHK-së, M3-III-22;
- f) "Shërbime mjetes transporti" Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23;
- g) "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" Niveli II i KSHK-së, T-II-19;
- gj) "Zhvillim Website" Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21;
- h) "Termohidraulikë" Niveli II i KSHK-së, V-II-20;
- i) "Instalime hidraulike" Niveli III i KSHK-së, V1-III-21;
- j) "Termohidraulikë" Niveli IV i KSHK-së, V-IV-23;
- k) "Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe ujit" Niveli II i KSHK-së, X-II-20;
- l) "Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit" Niveli III i KSHK-së, X1-III-23;
- ll) "Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe ujit" Niveli IV i KSHK-së, X-IV-18;

3. Afati përfundimtar "**Akreditimit të plotë**" është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1/a të nenit 18, të Urdhrit nr.128 datë 6.7.2021, "Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Industriale "Petro Sota" Fier, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisht të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Blendi Gonxhja

